



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 47, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LEJEN E ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBBIMESH 11, 12, 13, 14, 15 DHE 16 KATE MBI TOKË, ME
3 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “GJERGJ FISHTA”,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Arlis Ndërtim” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Lejen e Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 kate mbitokë, me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arlis Ndërtim” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 46, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 46, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Marrëveshja përkatëse për delegimin e kompetencave lidhur midis KKT-së dhe Bashkisë Tiranë, bashkëlidhur Vendimit Nr. 46, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: Godinë banimi dhe shërbimesh 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 kate mbitokë, me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arlis Ndërtim” sh.p.k, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
4. Të gjitha procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe shtyrjen e afateve, apo çdo ndryshim/rishikim i parashikuar në VKM-në 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në Ligjin Nr. 107/2014

“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në funksion të tij, ndërsa çertifikata e përdorimit referuar nenit 27 të VKM-së 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar do të lëshohet nga sekretariati i KKT-së.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALIUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/12/2025